

Përshëndetje z. B.,

Në vijim të email-it tuaj, lidhur me informacionin e kërkuar mbi thirrjet për punësimin e studentëve ekselentë në institucionet e administratës shtetërore, ju sqarojmë si vijon:

Departamenti i Administratës Publike ka realizuar 5(pesë) thirrje për punësimin me kontratë të përkohshme 1 vjeçare të studentëve të ekselencës, nga viti 2019 deri në vitin 2022. Informacionin për tre thirrjet e para e gjeni të pasqyruar në raportet vjetore të publikuara në faqen zyrtare të DAP, në linkun <https://www.dap.gov.al/publikime/raporte-vjetore>

Ndërkohë në prill të vitit 2022, në zbatim të vendimit nr. 665, datë 10.11.2021, të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë në vendimin nr. 586, datë 30.08.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore”, i ndryshuar, të gjithë të përzgjedhurit nëpërmjet platformës “Gati për Shqipërinë”, përjashtimisht për vitin 2021, iu dha e drejta të përzgjidheshin dhe të sistemoheshin me prioritet në pozicionet e dedikuara për studentët e ekselencës. Në platformën “Gati për Shqipërinë”, aplikuan 190 kandidatë, 42 prej të cilëve nënshkruan kontratën 1 vjeçare në institucionet e administratës shtetërore. Në korrik të vitit 2022, në zbatim të pikës 3, kreut II, të vendimit nr. 586, date 30.08.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike shpalli thirrjen e pestë për shprehjen e interesit për punësimin me kontratë të përkohshme 1 vjeçare të studentëve të ekselencës, në pozicionet specialist dhe të barazvlefshëm në institucionet e administratës shtetërore. Numri aplikantëve për këtë thirrje ishte 337, ku 57 prej tyre nënshkruan kontratën 1 vjeçare të punës. Informacionin e detajuar e gjeni të pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Numri i thirrjeve dhe periudha kohore	Numri aplikantëve	Numri i studentëve nënshkruan kontratën 1-vjeçare	Numri i studentëve që vijuan marrëdhënien në administratën publike në përfundim të kontratës 1 vjeçare
Thirrja I (4 mujori i parë i 2019)	1207	459	286
Thirrja II (4 mujori i dytë i 2019)	743	143	88
Thirrja III (nëntor 2020-janar 2021)	696	92	59
“Gati për Shqipërinë” (prill 2022)	190	42	
Thirrja V (korrik 2022)	337	57	

Në përfundim të kontratës 1 vjeçare në institucionet e administratës shtetërore, vijojnë ende procedurat e konkurrimit për pranimin në shërbimin civil për pozicionet të cilat ishin të plotësuar nga studentët ekselentë të dy thirrjeve të fundit.

*Lidhur me informacionin e kërkuar për pagat e pozicioneve ku janë të punësuar studentët ekselentë, sqarojmë:*

Pozicionet e punës të plotësuar nëpërmjet thirrjeve të ekselencës janë pozicione të kategorisë ekzekutive, dhe paga për këto pozicione përcaktohet sipas VKM nr.325, datë 31.5.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike” (<https://www.dap.gov.al/legjislacioni/per-administraten-publike/657-vkm-nr-321-date-31-05-2023-per-miratimin-e-struktures-se-pagave-niveleve-te-pagave-dhe-shtesave-te-tjera-mbi-page-te-zevendesministrit-funksionareve-te-kabineteve-prefektit-nenprefektit-nepunesve-civile-dhe-nepunesve-ne-disa-institucione-te-administrates>)

*Lidhur me pyetjen "A do të ofrohet mundësia e punësimit në administratë nëpërmjet këtij programi për vitin 2024?", sqarojmë:*

Në zbatim të pikës 3, të kreut II, të vendimit nr. 586, datë 30.08.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore” i ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike do të shpallë procedurën për shprehjen e interesit për punësimin me kontratë të përkohshme 1 vjeçare të studentëve të ekselencës, për institucionet e administratës shtetërore) në pozicionet specialist dhe të barazvlefshëm në institucionet e administratës shtetërore, brenda vitit 2024. DAP do të publikojë shpalljen për shprehjen e interesit për punësimin me kontratë të përkohshme 1 vjeçare të studentëve të ekselencës në faqen zyrtare, në rubrikën ekselencia në linkun <https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/6?excellence=6>, si dhe do të bëhet njoftimi në mediat sociale.

Bazuar në vendimin e sipërcituar, numri i pozicioneve të punës që do ju ofrohen ekselentëve për çdo vit kalendarik, nuk do të jetë më i madh se një e treta e numrit të pozicioneve të institucionit.

*Lidhur me pyetjen "Cilat kanë qenë pozicionet për juristë (në institucione në qytetin e Tiranës), vakanca e të cilave nuk u ezaurua edhe pas zhvillimit të procesit për pranimin e ekselentëve?", nga të dhënat që DAP administron, nuk ka patur pozicione për juristë që nuk janë përzgjedhur në qytetin e Tiranës.*

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,